



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 tetor 2017  
Nr.Ref.:RK1139/17

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KIo8/17**

Parashtrues

**N. S.**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës, CN. nr. 89/2015,  
të 14 gushtit 2015**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga N. S. nga Mitrovica (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, CN. nr. 89/2015, me të cilin është njohur vendimi i vendit të huaj.
3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai është njoftuar tërthorazi me përmbajtjen e këtij vendimi më 20 janar 2017.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesi po ashtu kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 1 shkurt 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
9. Më 11 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, dhe më 19 prill 2017, i dërgoi një kopje të saj Gjykatës Themelore në Mitrovicë.
10. Më 4 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, respektivisht Vendimin nr. 5799, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Tiranë si dhe të njëjtin vendim i cili është vërtetuar nga noteri në Prishtinë.
11. Më 5 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 3 dhjetor 2012, Gjykata e Rrethit në Tiranë (Vendimi 5799) kishte zgjidhur martesën në mes të parashtruesit të kërkesës dhe ish-bashkëshortes së tij.
13. Në një datë të paspecifikuar, ish-bashkëshortja e parashtruesit të kërkesës, e cila është shtetase e Shqipërisë, kishte parashtruar propozim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, që t'i njihej vendimi i gjykatës së Shqipërisë.
14. Më 14 gusht 2015, Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktvendimi CN. nr. 89/2015), "*propozimi është i bazuar*" dhe kishte njohur Vendimin e Gjykatës së Rrethit në Tiranë "*në kuptim të nenit 86-101 të Ligjit mbi zgjidhjen e konfliktit të ligjeve vendore me dispozitat e ligjeve të vendeve të huaja dhe mbi bazën e reciprocitetit*".

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

15. Parashtruesi i kërkesës pohon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe me nenin 32 [ E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
16. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se është shkelur e drejta e barazisë para ligjit, "*ngase më është injoruar fakti që jam shtetas i Kosovës, në ndërkohë që Gjykata ka konsideruar palën jo shtetase të Kosovës si shtetase të Kosovës*".
17. Parashtruesi më tej pretendon shkelje të së drejtës së tij për mjete juridike, sepse ai nuk kishte të drejtë të parashtronte ankesë ndaj "*një vendimi që mund të sjellë pasoja juridike për mua, si shtetas i Kosovës*".
18. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se "*Një vendim i formës së prerë [u dha] para 2 viteve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës*" dhe "*Nuk e kam pranuar fare. U njoftova lidhur me këtë më 20 janar 2017*".
19. Parashtruesi kërkon që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht "*për shkakun se emri im është irelevant në trajtimin e rastit dhe publiciteti në mënyrë të tërthortë do të mund të afektonte fëmijët e mi*".
20. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar nga Gjykata "*ta shpallë të pavlefshëm (jo valid) njohjen e Aktvendimit të Gjykatës së huaj (...), për shkak të miratimit me shkelje të procedurës dhe shkelje të gërmës së ligjit në fuqi*".

## **Pranueshmëria e kërkesës**

21. Gjykata i referohet nenit 46 [Lejueshmëria], i cili përcakton:

*"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore".*



22. Prandaj, Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:
- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
(...)”*
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
24. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47 (2) të Ligjit, i cili parasheh:
- “[...] Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
25. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse;*
- (b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”.*
26. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore në Mitrovicë, nuk e ka njoftuar për Aktvendimin CN. nr. 89/2015, të 14 gushtit 2015; ai është njoftuar tërthorazi me përmbajtjen e tij vetëm pas dy vitesh dhe, si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur mundësi ankese.
27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës deklaroi që *“një vendim i formës së prerë i para dy viteve (...) nuk mund të trajtohet në të njëjtin nivel gjykatë, e as në apel, prandaj e vetmja gjykatë meritorë është Gjykata Kushtetuese”.*
28. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pasi që është njoftuar me përmbajtjen e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, CN. nr. 89/2015, të 14 gushtit 2015, ka mundur së paku që të kërkojë nga Gjykata Themelore që ta njoftojë zyrtarisht për aktvendimin në fjalë apo të parashtrtojë kërkesë për rikthimin e afatit në Gjykatën e Apelit.
29. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur në dispozicion mjete juridike para gjykatave të rregullta të cilat ishin efektive, dhe kanë mundur të korrigjojnë shkeljet e pretenduara; por parashtruesi i kërkesës nuk e ka bërë këtë.

30. Përveç kësaj, Gjykata thekson se një mjet juridik në dispozicion sipas ligjit në fuqi nuk mund të konsiderohet joefektiv pa përpjekjen e parashtruesit të kërkesës që ta shterojë atë dhe të shohë nëse prodhon ndonjë efekt juridik.
31. Prandaj, Gjykata me tej konsideron se parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi të Kosovës. Shih, gjykata Kushtetuese rasti nr. KI07/09, *Demë dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendimi për papranueshmëri i 19 majit 2010 paragrafët 28-29).
32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parimi i subsidiaritetit dhe rregulli i shterimit të mjeteve juridike nga neni 113 (7) i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 36 (1) (b) i Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin lëndën e tyre në Gjykatë, që së pari të shfrytëzojnë mjetet efektive juridike të disponueshme me ligj.
33. Në të vërtetë, parimi dhe rregulli bazohet në supozimin se ekzistojnë mjete efektive juridike të cilat janë në dispozicion në raport me shkeljen e pretenduar në gjykatat e rregullta. Në të vërtetë, mekanizimi i mbrojtjes i themeluar me Konventë është subsidiar në raport me sistemin e rregullt të gjyqësorit që mbron të drejtat e njeriut. Shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, paragrafi 51; dhe *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetori 1976, paragrafi 48; shih gjithashtu, Gjykata Kushtetuese rasti KI42/15, të 4 korrikut 2016, paragrafët 34 dhe 35.
34. Vlerësimet më lart janë në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka vërtetuar se *“parashtruesi i kërkesës kurrë nuk e ngrehu këtë ankesë (...). Prandaj, kjo ankesë duhet të refuzohet për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike vendëse (...)*”. Shih rastin e GJEDNJ-së, *Erzebet PAP kundër Serbisë*, kërkesa nr. 44694, 21 qershor 2011, paragrafi 3.
35. Për më tepër, Gjykata konsideron se dokumentet shtesë të parashtruara më 4 shtator 2017 nuk ndikojnë në analizën e bërë deri më tash.
36. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj dhe vlerëson se ai nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
37. Prandaj, në bazë të nenit 113 (7) të Kushtetutës, të nenit 47 (2) të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se kërkesa është e papranueshme.

### **Kërkesa për moszbulim të identitetit**

38. Gjykata rikujton se parashtruesi kishte kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht *“për shkakun se emri im është irelevant në trajtimin e rastit dhe publiciteti në mënyrë të tërthortë do të mund të afektonte fëmijët e mi”*.
39. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 29 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:



*“Pala që parashtron kërkesë mund të kërkojë që identiteti i tij ose i saj të mos zbulohet publikisht dhe të paraqesë arsyet për këtë kërkesë. Gjykata mund të aprovojë kërkesën nëse vërteton se arsyet janë të bazuara mirë.”*

40. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, që përcakton:

*“Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.”*

41. Gjykata konsideron se në një rast familjar publiciteti mund, madje edhe në mënyrë të tërthortë, të ndikojë në identitetin, emrin dhe marrëdhëniet familjare të fëmijëve.
42. Prandaj, në pajtim me nenin 8 (1) të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rregullin 29 (6) të Rregullores së punës, Gjykata miraton kërkesën e parashtruesit si të bazuar për moszbulimin e identitetit të tij publikisht.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (b) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 5 shtator 2017, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Almiro Rodrigues



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi